



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада/ Government
Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return

Fushë Kosovë, datë: 15.05.2026.

Në përputhje me Kapitullin III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin nr. 08/L-260 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, bazuar në Nenin 4 paragrafi 1 (nënparagrafi 1.14), Shtojcën 14 të Rregullores (QRK)-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe bazuar në Nenin 9 të Vendimit nr. 362 të datës 04/05/2024. për përcaktimin e procedurës për ofrimin e ndihmës nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë që kanë nevojë për ndihmë. Projekte të zhvillimit ekonomik dhe projekte për individë dhe persona juridikë, shpallë:

THIRRJE PUBLIKE PËR NDARJEN E MATERIALIT NDËRTIMOR PËR PJESËTARËT E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË

Kjo thirrje publike synon të ofrojë mbështetje nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (në tekstin e mëtejshme MKK) për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës që kanë nevojë për ndihmë, duke siguruar dhe ndarë materiale ndërtimi për familjet ose individët që, për arsye ekonomike dhe sociale, jetojnë në kushte të vështira.

Kriteret për ndarjen e materialeve të ndërtimit për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë që kanë nevojë për ndihmë janë:

- 1) Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe më të vjetër se tetëmbëdhjetë (18) vjeç (të kenë një dokument identifikimi të Republikës së Kosovës);
- 2) Gjendje e vështirë ekonomike;
- 3) të kenë një shtëpi ose ndërtesë banimi që ka nevojë për renovim në mënyrë që të jenë në gjendje të jetojnë në të;
- 4) Që në tre vitet e fundit, aplikuesi ose një nga anëtarët e familjes të mos kenë përdorur ndihmë për ndërtimin e një shtëpie/banese ose renovim nga MKK ose institucione dhe organizata të tjera.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Aplikim/Kërkesë (e shkarkuar nga interneti) e plotësuar me të gjitha të dhënat dhe e nënshkruar nga aplikuesi;
2. Kopjet e letërnjoftimeve të aplikuesit dhe e të gjithë anëtarëve tjerë të rritur të familjes.
3. Certifikatat e lindjes për anëtarët e mitur të familjes;
4. Deklarata për bashkimin familjar;
5. Deklarata nën betim (e shkarkuar nga interneti) se në tre vitet e fundit nuk ka marrë ndihmë për ndërtimin ose renovimin e një shtëpie/banese (e nënshkruar nga aplikuesi);
6. Specifikat e materialit ndërtimor të kërkuar (lloji i materialit, sasia dhe specifikat e tjera teknike)
7. Dëshmi se ai merr ndihmë sociale (nëse ka);
8. Dëshmi e të ardhurave mujore nën pagën mesatare (nëse ka);

9. Dokumente të tjera mbi gjendjen shëndetësore të aplikuesit ose anëtarëve të tjerë të familjes (nëse ka).

Çfarë lloj materiali ndërtimor ndahet

Materialet e mëposhtme të ndërtimit jepen vetëm dhe ekskluzivisht përmes kësaj ftese:

- *Blloqe argjile me përmasa 25x19x19*
- *Çimento 50 kg*
- *Beomall 50 kg*
- *Trashësia e stiroporit T=8cm*
- *Trashësia e stiroporit T=5cm*
- *Stirodur 5cm i trashë*
- *Ngjitës i zi për stiropor 25 kg*
- *Fasadë akrilike 25L*
- *Armatur me brinjë me profile 12 mm*
- *Armatur me brinjë 10 mm*
- *Armatur me brinjë 8 mm*
- *Armatur me brinjë 6 mm*
- *Rrjetë me brinjë Q335 - 8.0x8.0 mm, distanca 150x150 mm*
- *Pllaka muri qeramike*
- *Pllaka dysHEMEJE qeramike*
- *Ngjitës për pllaka qeramike 25 kg*
- *Derë druri (mediapan) 90x120 cm*
- *Derë hyrëse PVC 100x120 cm, gjerësia e profililit 82 mm*
- *Dyer dhe dritare nga PVC-ja, dimensionet 80x120 cm, gjerësia e profililit 82 mm, 2 xhama, me xham 4+12+4*
- *Trarë për çatinë - dimensionet 10x12x600 cm*
- *Listela druri për çatinë 3x5 cm*
- *Fibra difuze për izolim çatie me cilësi të lartë*
- *Pllaka qeramike*
- *Pllaka qeramike për mbulesa çatie*
- *Zhavorr*

Vlera maksimale e ndihmës në formën e materialit ndërtimor është 3,000 euro, sipas çmimeve aktuale të tregut në Kosovë.

Informata shitesë

Kategoritë e mëposhtme duhet të kenë përparësi në kushte të barabarta:

1. *Përfituesit potencialë me anëtarë të familjes me nevoja të veçanta;*
2. *Përfituesit potencialë me anëtarë të familjes në gjendje të rëndë shëndetësore;*
3. *Përfituesit potencialë me fëmijë nën 5 vjeç;*
4. *Përfituesit potencialë pa të ardhura ose që përfitojnë nga skema e ndihmës sociale;*
5. *Përfituesit potencialë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike;*
6. *Prindi vetëushqyesë.*

Vërejtje:

Përfituesit do të jenë persona fizikë të renditur nga komisioni i vlerësimit me numrin më të lartë të pikëve, varësisht nga kufizimet e planifikuara buxhetore. Të gjithë përdoruesit janë të detyruar të përdorin ndihmën e marrë për qëllimin e kërkuar.

Periudha e aplikimit:

Kjo thirrje publike është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim <https://mkk.rks-gov.net/>. Ju mund ti gjeni të gjitha informatat dhe formularët e nevojshëm të aplikimit për këtë thirrje publike si në këtë faqe interneti ashtu edhe në vetë ndërtesën e Ministrisë. Aplikuesit që dëshirojnë të aplikojnë për këtë thirrje publike duhet të shprehin interesin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në formë fizike në arkivat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, rr.. Nëna Terezë, PB. 12000 Fushë Kosova/Republika e Kosovës.

Regjistrimi për këtë thirrje publike fillon më 15.05.2026 dhe thirrja do të jetë e hapur deri më 29.05.2026 deri në orën 15:00 dhe aplikimet pas këtij afati nuk do të pranohen.

Informacione dhe sqarime shtesë mund të merren direkt nga zyrat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.